

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Përgjegjës Sektori, Drejtorja e Koordinimit të Projekteve, Sektori Inspektim-Monitorim i Projekteve (Kategoria III-a).

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar); VKB Nr.169, datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr.2236, datë 08.08.2024 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
- Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, *(për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësimi nga MAS)*;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zotërimi i nje gjuhe të huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Përgjegjësi i Sektorit ka detyra si më poshtë:

Përgjegjësi i Sektorit, varet nga Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit të Projekteve.

1. Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Drejtori i Drejtorisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
2. Organizon, koordinon dhe drejton punën e drejtorisë, nëpërmjet shpërndarjes së detyrave, kërkesës së llogarisë, marrjes së masave dhe paraqitjes së propozimeve;
3. Koordinimi i projekteve të miratuara me vendim të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë;
4. Ndjekja e zbatimit të projekteve në procesin e zbatimit dhe mbajtja e kontakteve zyrtare me ASHK dhe ZVRPP për statusin juridik të pronave të prekura nga Projektet e Bashkisë Tiranë;

5. Përgatitja e shkresave të ndryshme drejtuar institucioneve të ndryshme apo individëve për zbatimin e projekteve;
6. Koordinimi me sektorë të tjerë të Institucionit për nevoja të ndryshme në mjete apo burime njerëzore;
7. Hartimi i një plani pune mujor të detajuar për zbatimin në kohë reale të projekteve;
8. Lirimi i shesheve të ndërtimit për realizimin e projekteve të planifikuara;
9. Ndjek zbatimin e afateve për zbatimin e projekteve dhe raporton tek Drejtori i Drejtorisë mbi problematikat e konstatuara duke propozuar dhe zgjidhjen e tyre.

Dokumentat që aplikanti për Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Koordinimit të Projekteve, Sektori Inspektim-Monitorim i Projekteve duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (Bachelor + Master Shkencor) ose Diplomë e Nivelit të Dytë, dhe listë notash të noterizuara (*për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhsimi nga MAS*);
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi)

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë zyrave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, në adresën : Rr: “Asim Vokshi”, Nd.10, H.4, Ap.3, 1057, Tiranë, afati është deri me datë 06.09.2024 **ora** 14.00.